

V E N D I M
Nr. 463, datë 6. 10.1999

**PËR CAKTIMIN E TENDERIT SI FORMË TË PRIVATIZIMIT TË PAKETAVE TË
AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TREGTARE, QË VEPROJNË NË SEKTORË
JOSTRATEGJIKË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutes, të nenit 3 të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, dhe të kap.I, pikat 1 dhe 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.529, datë 21.8.1998 “Për procedurat e tenderimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare, që zotërohen nga shteti”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Tenderi i hapur të jetë forma e shitjes së paketës së aksioneve të shoqërive tregtare:
 - Birra Malto, Tiranë, Sha;
 - Kantina e pijeve “Gjergj Kastrioti”, Durrës, Sha;
 - “Prodhime Farmaceutike”, Tiranë, Sha;
 - Fabrika e qumështit “Ajka”, Tiranë, Sha.
2. Kriteri bazë për vlerësimin e ofertave të jetë çmimi i ofruar, ndërsa për kriteret e tjera, të vlerësimit pikësor të ofertave me tender, të jenë:
 - Niveli i investimit të propozuar;
 - Plani i biznesit dhe cilësia teknike e propozimit;
 - Cilësia e investitorit, e matur nga arritjet e tij në fushën e biznesit, gjendja financiare dhe aftësia për menaxhimin e shoqërisë, që ofrohet në tender;
 - Tregues të punësimit dhe të ritrajnimit për stafin dhe për specialistët.
3. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të nxjerrë urdhrin për përgatitjen e dokumentacionit të privatizimit me tender dhe të pikëve të vlerësimit të ofertave për secilën shoqëri.
4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, organet e varësisë administrative dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko